



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

E K S T R A K T

Nga procesverbali i mbledhjes së 23-të të Kuvendit të Komunës së Lipjanit mbajtur, më 23.09. 2019, në sallën e Kuvendit me fillim në ora 10⁰⁰

Në mbledhje prezentuan:

1. Daut Azemi, Kryesues i Kuvendit
2. Mehmetali Krasniqi, anëtar
3. Nehat Tërpeza, anëtar
4. Fadil Sopa, anëtar
5. Hyra Bytyçi, anëtare
6. Anila Reçica, anëtare
7. Ramadush Tasholli, anëtar
8. Naim Jahiri, anëtar
9. Naim Stullca, anëtar
10. Majlinda Sylejmani, anëtare
11. Fatime Krasniqi, anëtare
12. Arif Miftari, anëtar
13. Lulzim Rrustemi, anëtar
14. Ramiz Qeriqi, anëtar
15. Argjent Tasholli, anëtar
16. Nazmi Krasniqi, anëtar
17. Lumturije Bytyqi-Hasani
18. Egzona Bytyqi, anëtare
19. Shkelzen Bislimi, anëtar
20. Albulena Kelmendi, anëtare
21. Alban Salihu, anëtar
22. Afrim Miftari, anëtar
23. Hajdin Bytyqi, anëtar
24. Safete Amerllahu, anëtare
25. Bashkim Budakova, anëtar
26. Ukë Kryeziu, anëtar
27. Ganimete Qeriqi, anëtare
28. Manush Shamolli, anëtar
29. Egzona Fazliu, anëtare
30. Arben Salihu, anëtar
31. Fehmi Rexhepi, anëtar

Të tjerë prezent:

1. Imri Ahmeti, Kryetar i Komunës
2. Fauz Xhemajli, Nënkyetar i Komunës
3. Lulzim Qerimi, Nënkyetar i Komunës

4. Avni Olluri, drejtor i DA
5. Shkelzen, Hajdini, drejtor i DEZH
6. Rasim Hasani, drejtor i DKA
7. Latif Ramadani, drejtor i DBF-së
8. Emina Rexhiq, drejtoreshë e DPU
9. Ilir Tasholli, drejtor i DSHP
10. Imer Rrustemi, drejtor i DI,
11. Bekim Shabani, drejtor i DRKS
12. Shefqet Amerllahu, drejtor i DBPZHR
13. Visar Kozhani, zyrtar i DBF-s
14. Vlorë Limani-Hajnuni DSHMS
15. Vlorë Krasniqi, zyrtare ligjore
16. Bukurie Zejnullahu, zyra e informimit
17. Besart Troshupa, zyra e informimit
18. Bekim Krasniqi, OJQ "YAHK"
19. Kimete Jashanica, OSBE
20. Bestar Ibrahim, i
21. Përfaqësues të mediave dhe numër i konsiderueshëm i qytetarëve

Procesverbalin nga kjo mbledhje e mbajti **Rrahim Krasniqi**.

Kryesuesi i Kuvendit Daut Azemi, pas konstatimit se në mbledhje prezentojnë 25 anëtarë nga gjithsej 31 anëtarë të Kuvendit hapi mbledhjen duke përshëndetur të pranishmit.

Pastaj tha se rendin e ditës së bashku me material e keni marrë dhe në vazhdim lexoi rendin e ditës të propozuar.

REND DITE

1. Aprovimi i ekstraktit nga mbledhja e 21-të dhe 22-të Kuvendit.
2. Propozim vendim mbi aprovimin e buxhetit për vitet 2020-2022.
3. Propozim vendim për shpalljen e interesit publik për shpronësim të paluajtshmërive.
4. Propozim Rregullore për organizimin, funksionimin dhe bashkëpunimin e komunës me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane.

Daut Azemi, Kryesues i Kuvendit, pyeti se a ka dikush vërejtje apo plotësime rreth rendit të ditës.

Megjithatë nuk pati rreth rendit të ditës Kryesuesi të njëjtin e vuri në votim dhe pas votimit konstatoi se 27 vota për, kaloi rendi i ditës.

Daut Azemi, Kryesues i Kuvendit, tha se kam një propozim që këtë seancë të Kuvendit mos të ket pyetje por të kalohet në rend të ditës dhe propozimin e vuri në votim dhe pas votimit konstatoi se me 17 vota për, 8 kundër, kaloi ky propozim.

Pastaj u kalua në punë sipas pikës së parë.

I

Aprovimi i ekstrakteve nga mbledhja e 21-të dhe 22-të Kuvendit

Lidhur me këtë pikë, Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, pyeti anëtarët se a ka dikush vërejtje apo plotësime në ekstraktet të cilat i keni marrë.

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Megjithatë nuk pati Kryesuesi vuri në votim ekstraktin nga procesverbali i mbledhjes së 21-të dhe 22-të dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 19 vota për

**Aprovoi
Ekstraktet nga mbledhja e 21-të dhe 22-të Kuvendit**

Shtesë: Ekstrakti.

II

Propozim vendim mbi aprovimin e buxhetit për vitet 2020-2022.

Lidhur me këtë pikë Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, i dha fjalën Latif Ramadanit, drejtor i DBF-së, i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozim vendimi .

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Hyra Bytyçi, ne si grup parlamentar e aprovojmë këtë propozim vendim pasi që e konsiderojmë që është gjithëpërfshirës, është planifikuar sipas kërkesave dhe nevojave të qytetarëve nga dëgjimet publike ku gjithsej janë mbajtur 16 dëgjime. Po ashtu buxheti është në rritje për 2 milion euro. Gjatë këtij buxheti janë planifikuar dy çerdhe, dy shkolla e shumë projekte tjera.

Lulzim Rrustemi, nuk është mirë që të na mohohen pyetjet parlamentare pasi që është një herë në muaj seanca dhe ne takohemi me qytetarë dhe duhet t'i ngrisim shqetësimet e qytetarëve. Sa i përket buxhetit ne kemi vërejtjet tona, por rritja e buxhetit është për t'u përshëndetur. Një numër i kërkesave të qytetarëve gjatë dëgjimeve buxhetore nuk janë marrë parasysh. Ky buxhet nga 66 projekte 24 prej tyre janë rrugë e rrugica, ndërsa 6 trotuare. Kemi mungesë të projekteve rreth ujit të pijëshëm ku ka pasur kërkesa të qytetarëve dhe nuk janë marrë parasysh në përjashtim të rehabilitimit të ujit të pijëshëm në Krojmir. Sa i përket investimit nëpër shkolla kemi shumë pak investime ku ka mungesë të bibliotekave nëpër shkolla, po ashtu edhe në kabinete ka shumë pak investime. Rehabilitimi i ujërave të zeza ka qenë një projekt për fshatrat Qylagë, Dobrajë dhe Blinajë dhe si duket është heq. Bujqësia dhe shëndetësia kemi pak investime, një buxhet i cili nuk ka ecje përpara e ku nuk do të ketë as zhvillim ekonomik as vende të reja pune. Ne këtë buxhet si të tillë nuk do ta përkrahim.

Egzona Fazlija, ne si nismë jemi kundër ndarjes së këtij buxheti pasi që ky buxhet është i ndarë në baza partiake dhe si Nismë Social Demokrate jemi kundër ndarjes së këtij buxheti.

Lumturije Bytyqi-Hasani, unë edhe në dëgjimet publike vazhdimisht kam insistuar për çerdhe publike, mirë që është përfshirë çerdhja në Gadime dhe Sllovi por nuk e dijë pse është heqë çerdhja në Shalë. Qëndrimi im do të jetë kundër këtij buxheti për arsye se çerdhja në Shalë nuk është përfshi. Pse nuk është parapa të paktën në vitet në vijim?

Imri Ahmeti, Kryetar i Komunës, e rëndësishme e këtij buxheti është se kemi rritje prej 2 milion euro. Kur e kam marrë unë komunën investimet kapitale kanë qenë 18%, ndërsa tani janë rritur me 28% dhe kjo shkon në dobi të qytetarëve dhe nuk ndahet buxheti vetëm për një parti pasi që nuk ndërtohet as trotuari as fusha e sportit as rruga vetëm për një parti por për të gjithë qytetarët. Nëpër shkolla nuk kemi pasur as nxemje tani është krejt ndryshe ka nxemje, ka infrastrukturë të re e kabinete, rrethoja të shkollave e shumë investime tjera. Sa i përket ujësjellësit kemi marrëveshje me CDI-n për lokalitetet ku nuk ka ujë dhe ata janë duke i bërë hulumtimet.

Lulzim Rrustemi, unë i kam dy pyetje te paga dhe medijtjet te zyra e Kryetarit te korniza afatmesme buxhetore ka një rritje prej 8 mijë euro. Dhe te Gllgovci rikostruimi i trotuareve dhe ndriçimi poblik çka do me thënë. Po ashtu kam një vërejtje një rrugë mbrapa ABES e shtrume që disa vite tash prap po prishet është mirë që projektet të planifikohen mirë e jo çdo vit në të njëjtat rrugë të punohet.

Imri Ahmeti, Kryetar i Komunës, rikonstruimi në Gllgovci është ndërpre kontrata për shkak të keq implementimit të kontratës. Por na atë projekt tash kena me vazhdu. Sa i përket rrugës pas ABES ajo është shtru para tri mandateve dhe është bërë pa u përfshi kanalizimi, ujësjellësi dhe tani duhet të intervenohet.

Meqë diskutime tjera rreth kësaj pikë nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozim vendimin dhe pas votimit Kuvendi konstatoi se me 22 votat për, 6 kundër, 1 apstenim aprovoi këtë:

VENDIM
MBI APROVIMIN E BUXHETIT PËR VITET 2020-2022

Neni 1

Me këtë Vendim aprohet Buxheti për vitet 2020-2022 për Komunën e Lipjanit.

Neni 2

Buxheti për vitet 2020-2022 do të financohet:

FONDI BURIMOR	VITI 2020	VITI 2021	VITI 2022
Grant i Përgjithshëm	6,156,011.00	6,496,608.00	6,884,382.00
Grant Specifik i Arsimit	7,494,228.00	7,531,699.00	7,569,357.00
Grant Specifik i Shëndetësisë	2,104,564.00	2,188,746.00	2,276,296.00
Të hyrat vetanake	2,080,919.00	2,154,214.00	2,227,862.00
Financimi Shërbimet Rezedenciale	170,000.00	170,000.00	170,000.00
TOTALI	18,005,722.00	18,541,267.00	19,127,897.00

Neni 3

Mjetet nga neni 2.i këtij Vendimi do shpërdahen në kategorit ekonomike si vijon:

KATEGORITE EKONOMIKE	VITI 2020	VITI 2021	VITI 2022
Paga e Mëditje	10,813,429.00	11,404,831.00	11,896,115.00
Mallra dhe Shërbime	1,515,000.00	1,515,000.00	1,515,000.00
Shërbime Komunale(Komunalit)	250,000.00	250,000.00	250,000.00
Subvencione dhe Transfere	350,000.00	350,000.00	350,000.00
Investime Kapitale	5,077,293.00	5,021,436.00	5,116,782.00
TOTALI	18,005,722.00	18,541,267.00	19,127,897.00

Neni 4

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Drejtoria për Buxhet dhe Financa.

Neni 5

Hyrja në fuqi

Ky Vendim hyn në fuqi 7 ditë pas publikimit në Webfaqen e Komunës.

Neni 6

Me këtë Vendim të njoftohet Drejtoria për Buxhet dhe Financa, ndërsa një kopje ruhet në materialin e Kuvendit.

Shtesë: Vendimi.

III

Propozim vendim për shpalljen e interesit publik për shpronësim të paluajtshmërive

Lidhur me këtë pikë Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, i dha fjalën, Sefer Tashollit, drejtor i DGJK-së, i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozim vendimi .
Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Lulzim Rustemi, ne e kemi shqyrtu këtë projekt dhe këtë do të duhej të ipen vërejtjet edhe për punën që është duke u bërë pasi që kur bëhet planifikimi duhet të jetë në përputhje me terenin. Kjo është vërejtja ime.

Majlinda Sylejmani, ne si grup parlamentar i LDK-së e përkrahim këtë propozim vendim pasi që është nevojë e shpronësimit shtesë.

Afrim Miftari, ne e kemi pas edhe më herët një vendim dhe ky është një vendim shtesë dhe gjatë implementimit mund të ket probleme siqë ka ndodhur edhe me këtë projekt është e kuptueshme që mund të ndodhin probleme. Ne si grup i japim përkrahje.

Meqë diskutime tjera rreth kësaj pikë nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozim vendimin dhe pas votimit Kuvendi konstatoi se me 24 votat për, aprovoi këtë:

VENDIM PËR SHPALLJEN E INTERESIT PUBLIK PËR SHPRONËSIM TË PALUAJTSHMERIVE

Neni 1

Miratohet Vendimi për shpalljen e interesit publik për shpronësim shtesë të paluajtshmerive të pronarëve dhe zotëruesve të interesit të cilat preken nga projekti për ndërtimin e rrugës me trotuar, ndriçimi publik në lagjen e Konjuhut rreth shtratit të lumit Janjevka në Lipjan, sipas listës së pronave të përshkruara nga evidenca kadastrale përkatëse për titullarët e pronave të paluajtshme, pozitën e tyre në kuadër të projektit të interesit publik, si dhe sipërfaqet e tyre të cilat tabela paraqesin pjesët përbërse të këtij Vendimi.

Neni 2

Vlera e kompensimit të pronës caktohet nga Zyra për Vlerësimin e Pronës së Paluajtshme në kuadër të Ministrisë së Financave të Republikës së Kosovës konform Ligjit Nr.03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme, me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin nr.03/L-205 të datës 28 tetor 2010 dhe Udhëzimit Administrativë nr.02/2015 për miratimin e metodave dhe kriterëve teknike të vlerësimit për përlllogaritjen e shumës së kompensimit për pronën e paluajtshme që shpronësohet dhe dëmeve që kanë të bëjnë me shpronësimin.

Neni 3

Obligohet Zyra e Kryetarit-sektori pronëso-ro-juridik pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi të zhvilloj procedurat e shpronësimit në pajtim me dispozitat të Ligjit Nr.03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme, me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr.03/L-205 të datës 28 tetor 2010.

Neni 4

Për zbatimin e këtij Vendimi obligohen: Zyra e Kryetarit-Sektori pronëso-ro-juridik, Drejtorati për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit, Drejtorati për Buxhet dhe Financa, Drejtorati për Gjeodezi dhe Kadastër dhe Drejtorati i Shërbimeve Publike.

Neni 5

Ky vendim hyn në fuqi 7 ditë pas publikimit në faqen elektronike të Komunës.

Shtesë: Vendimi.

IV

Propozim Rregullore për organizimin, funksionimin dhe bashkëpunimin e komunës me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane.

Lidhur me këtë pikë Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, i dha fjalën, Avni Ollurit, drejtor i DA-së, i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozim Rregullorja.

Daut Azemi, në KPF janë ardh dy rekomandime që të fshihet neni 9 dhe po ashtu edhe te pjesa tjetër të shtihet edhe drejtorët e drejtorive komunale mos të jenë pjesë kryetarët të këshillave. Ky rekomandim ka ardhur për arsye se Lipjani për momentin ka 52 këshilla të fshatrave. Po ashtu gjatë një punëtorie së bashku me drejtorin Latif Ramadani e kemi kundërshtu udhëzimin por e kanë kundërshtu edhe regjioni i Prishtinës.

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Lumturije Bytyqi-Hasani, ne edhe në KPF e kemi diskutu këtë propozim Rregullore, në fokus nenin 9 por nuk ka qenë shumë e çart me u hiq neni 9 apo jo, ku na e kemi një udhëzim administrativ dhe në bazë të banorëve neve na obligon me pas numrin e këshillave maksimumin 25. Dhe këshilla ime është me kërku një këshillë nga Ministria me ju dërgu një shkresë që ne jemi të pakënaqur me këtë udhëzim e jo të bëjmë një Rregullore në kundërshtim me udhëzimin.

Egzona Fazlija, është për tu përshëndetur kjo propozim Rregullore vetëm kam një kërkesë që në komisionin për zgjedhjen e këshillit të fshatrave të jetë nga një përfaqësues i të gjitha subjekteve politike të përfaqësuar në Kuvend.

Albulena Kelmendi, na edhe në KPF e kemi diskutu këtë propozim Rregullore, pavarësisht që është nxjerrë një udhëzim ne e mbrojmë qëndrimin që duhet të shihen specifikat e secilës komunë. Komuna e Lipjanit ka shumë fshatra dhe nëse bëhet me vetëm 25 këshilla kjo i bjen që 3-4 fshatra me u përfshi me një këshill. Edhe unë jam për me u dërgu një shkresë në ministri por mendoj që 25 këshilla janë pak.

Daut Azemi, Kryesues i Kuvendit, unë kam qenë kryetar i komisionit të këshillit të fshatrave dhe ky këshill është përfaqësuar nga të gjitha subjektet politike, asnjë këshill nuk është zgjedh në baza partiake dhe përgjedhja është bërë në bazë të vullnetit të qytetarëve të cilët kanë qenë prezent.

Afrim Miftari, ne edhe në KPF e kemi diskut kemi dhënë rekomandimet tona rreth neni 9 por unë kam pas vërejtje edhe te neni 14 te kuota gjinore 30% ku është shumë e vështirë m'u arrit. Nëse fillojmë me implementu në teren cilat kanë me qenë vështirësitë. Ne duhet të vazhdojmë me Rregulloren e vjetër deri sa të sqarohen disa nene të cilat janë ma problematike të Rregullores së re.

Ukë Kryeziu, është mirë që është bërë kjo Rregullore por a do ta rregulloj kjo Rregullore këtë çështje në bazë të udhëzimit administrativ unë mendoj që jo. Ne duhet të diskutojmë dhe ta japim fjalën përfundimtare se çka do të bëjmë me këtë Rregullore. Ne kemi pasur edhe më herët një Rregullore dhe me atë Rregullore kanë qenë të përfaqësuar të gjitha subjektet politike, a kanë qenë politike dhe sa kanë qenë funksionale nuk mund të them. Sa i përket këtyre këshillave ka pasur numër të vogël të cilët kanë marrë pjesë në zgjedhje të këshillave. Këtë çështje do ta rregullonte vetëm një Ligj. Nuk po funksionojnë këshillat e fshatrave të cilat po i zgjedhim por edhe ato po janë të ndikuara nga pushteti. As një këshill nuk po e ka pelqimin e shumicës qytetare. Duhet të përfshihet edhe KKZ-ja në këto zgjedhje të bëhen njoftimet me kohë. Komisioni të caktoj datat dhe numrin minimal i personave që do të marrin pjesë në votim dhe të zgjedhet një këshill që i përfaqëson si duhet qytetarët. Duhet të bëhet një Rregullore funksionale e jo sa për sy e faqe.

Daut Azemi, edhe më herët kanë qenë të ftuar publikisht dhe ti Ukë ke qenë bashk me mu në komision dhe në pushtet dhe komisioni ka vendos për këshilla të fshatrave por nuk do me thënë që ka qenë numri i vogël i pjesëmarrësve pasi që kemi pasur rast kur kanë marrë

pjesë edhe numri i madhe i pjesëmarrësve deri në 200 dhe në fund raporti ka qenë i nënshkruar nga të gjithë anëtarët e komisionit.

Lumturije Bytyqi-Hasani, edhe unë pajtohna me Egzonen që të rritet numri i anëtarëve të komisionit nga 4, të përfaqësohen nga të gjitha subjektet në Kuvend.

Hyra Bytyçi, ne si grup parlamentar i LDK-së e përkrahim këtë propozim Rregullore me rekomandime të Kuvendit që të rritet numri i kështillave të fshatit.

Lulzim Rrustemi, është mirë me shku me rekomandim për ndryshim të Rregullores pasi që ka mundësi me na u kthi e jashtëligjshme nga MAPL-ja.

Avni Olluri, varësisht nga nevojat në teren po themi që të rriten edhe këshillat e fshatrave.

Meqë diskutime tjera rreth kësaj pikë nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozim Rregulloren sipas rekomandimeve të Kuvendit që të hiqet neni 9 dhe të mos përfshihen në këshilla drejtorët e drejtorateve komunale. Pas votimit Kuvendi konstatoi se me 16 votat për, 4 kundër, 6 apstenim aprovoi këtë:

Pasi çështje të tjera nuk pati mbleldhja përfundoi në ora 11,²⁰

Ekstraktin e hartoi
Behar Ali

Kryesuesi i Kuvendit
Daut Azemi